

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
 Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
 Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije
 Ministry of Finance
 Arkiva - Arhiva - Archive

Njësia Org.
 Org. Unit: 01
 Nr. Prot.
 Br. Prot. No: 1005

Nr. i faqeve
 Broj stranica No. pages: 09
 Data
 Datum Date: 15.05.2014

Dalëse
 PRISHTINË/A



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave
Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance

Departamenti i Buxhetit Komunal / Departman Opstinskog Budzeta / Municipality Budget Department

REFERENCE:	
PËR/ZA/TO:	Kryetarët e Komunave Drejtorët për Buxhet dhe Financa Drejtorët e Drejtorive Komunale Zyrtarët Kryesor Financiar
CC:	Petrit Popova, Drejtor i Departamentit të Buxhetit Komunal në MF
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Besim Beqaj, Ministër i Financave
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Qarkorja Buxhetore 2015/01 për Komuna
Nr. i zyrës: Br. kancelarije: Room No.:	Lokacioni: Kucni: Extension:
	Data: Datum: Date:
	14 Maj 2014

Të nderuar Kryetarë të Komunave,

Me Qarkoren Buxhetore 2015/01 për Komunat, ju njoftojmë për zhvillimin e procesit buxhetor komunal në pajtim me kalendarin dhe procedurat e përcaktuara në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi (LMFPP).

Ministri për Financa është i autorizuar dhe përgjegjës që në përputhje me Nenin 20 të LMFPP, të nxjerrë qarkore buxhetore për të gjitha organizatat buxhetore, me të cilat sigurohen udhëzime për përgatitjen e Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin fiskal.

Qarkorja buxhetore 2015/01 për komunat, ofron udhëzimet e para, kalendarin kohor indikativ si dhe kufijtë fillestarë të financimit për përgatitjen e buxhetit të propozuar komunal dhe kërkesës për ndarje buxhetore për vitin 2015-2017.

Nga ju të nderuar kryetarë të komunave, kërkohet ta shpërndani këtë qarkore tek të gjithë drejtorët e drejtorive komunale, përkatësisht tek stafi i përfshirë në procesin buxhetor komunal dhe përgatitjen e kornizës afatmesme buxhetore komunale (KAB Komunale 2015-2017), duke vazhduar më pas me nxjerrjen e qarkores së brendshme buxhetore komunale si bazë për planifikimin e buxhetit tuaj komunal për vitin 2015-2017.

Kjo Qarkore do të jetë e para në serinë e qarkoreve që do të sigurojnë informata për Komunat lidhur me zhvillimin e procesit buxhetor komunal për vitet 2015-2017.



Zhvillimi i procesit buxhetor komunal për vitin 2015

- Zbatimi i Vendimit të Qeverisë Nr.09/121 të datës 27.03.2013 për ndryshimin e Shtojcës 1 të LFPL për numrin e ri të popullsisë (**shtojca 1 dhe Shtojca 3** - Kriteret bazë të aplikuara për grantin e Përgjithshëm dhe shëndetësisë).
- Kriteret bazë të aplikuara për grantin specifik të Arsimit parauniversitar (**shtojca 2**).
- Financimi i shërbimeve rezidenciale në dy komunat Skenderaj dhe Graçanicë përkatësisht aprovimi i ndarjes buxhetore dhe numrit të stafit, (**shtojca 5**), ku në tabelat e buxhetit për vitin 2015 do të pasqyrohet si nën-program i veçantë buxhetor “Shërbimet Rezidenciale” në kuadër të programit të ri buxhetor “Shërbimet Sociale dhe Rezidenciale”.
- Të punësuarit në administratën e Drejtorive Komunale për Arsim parauniversitar, duhet të financohen nga Granti i Përgjithshëm (**shtojca 1**).
- Të punësuarit në administratën e Drejtorive Komunale për Shëndetësi primare dhe Shëndetësi sekondare duhet të financohen nga Granti i Përgjithshëm (**shtojca 1**).
- Komunat gjatë hartimit të buxhetit për vitin 2015, do të kenë fleksibilitet në planifikimin e të hyrave vetanake nëpër kategoritë ekonomike, duke përjashtuar kategorinë Paga dhe meditje dhe kapitalet.
- Komunat e përfshira në decentralizimin e buxhetit në nivel të shkollës duhet të përgatisin buxhetet e tyre për ekzekutim për të gjitha shkollat.

Konteksti për përgatitjen e buxhetit komunal për vitin 2015

Me qëllim të përmbushjes së afatit ligjor për përgatitjen e projektbuxhetit në kohën e duhur dhe që është më i përgjegjshëm në aspektin fiskal, është thelbësore që të gjitha komunat të veprojnë në pajtim me kalendarin buxhetor të përcaktuar në LMFPF dhe kërkesat e specifikuara në këtë qarkore dhe qarkoret tjera pasuese buxhetore si dhe në përputhje me dispozitat e aplikueshme në fuqi.

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve Komunale si pjesë integrale e KASH 2015-2017, është aprovuar në Qeveri me datë 29 Prill 2014 Vendimi Nr. 01/186, e cila përfshinë prioritetet afatmesme strategjike dhe prezanton burimet e financimit për komunat për vitet 2015-2017. Qeveria e Republikës së Kosovës është e përkushtuar që në rend të parë të ruaj stabilitetin fiskal e buxhetor dhe të mbështesë prioritetet sektoriale afatmesme.

Në linjë me Programin qeveritar, profili i strukturës së shpenzimeve sipas kategorive ekonomike do të ketë fleksibilitet për planifikimin e shpenzimeve nga të hyrat vetanake komunale për vitin 2015. Pra, komunat gjatë hartimit të buxhetit për vitin 2015, do të kenë fleksibilitet në planifikimin e të hyrave vetanake nëpër kategoritë ekonomike (duke përjashtuar kategorinë ekonomike Paga&Meditje dhe kapitalet).

Ndërsa, sa i përket planifikimit dhe shpenzimit të të hyrave vetanake në sektorin e arsimit dhe shëndetësisë, i referoheni dispozitave ligjore të përcaktuar në LMFPF, LFPL dhe ligjin vjetor të buxhetit.

Numri i të punësuarve mbetet në nivel të vitit paraprak, ndërsa masa monetare për paga dhe meditje do të përfshijë rritjen e pagave prej 25% sipas Vendimit të Qeverisë Nr.01/176 datë



10 Mars 2014, si dhe në raste kur për këtë ekziston ndonjë Vendim paraprak nga Kuvendi apo Qeveria e Republikës së Kosovës.

Buxhetet komunale për vitin fiskal 2015, do të përgatiten sipas pesë kategorive ekonomike për shpenzime të buxhetuara, në pajtim me rregullat financiare për shpenzime (SIMFK) të lëshuara nga Thesari, si vijon: Paga&Mëditje, Mallra dhe Shërbime, Shpenzime Komunale, Subvencione dhe Transfere dhe Shpenzime Kapitale.

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2015-2017

Duke u mbështetur në obligimet që dalin nga Ligji Nr. 03/L-221 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Nenit 5, Qeveria ka aprovuar Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve për periudhën 2015-2017, dhe ka dorëzuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Ky dokument përmban katër kapituj kryesor, si vijon:

- ✓ Deklarata e prioriteteve afatmesme të Qeverisë 2015-2017
- ✓ Korniza Makro-Fiskale 2015-2017
- ✓ Trendi i shpenzimeve dhe vlerësimet e ardhshme sipas sektorëve nga Niveli Qendror
- ✓ KASH Komunale 2015-2017.

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve Komunale 2015-2017

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve Komunale 2015-2017, prezanton shumat agregate të granteve qeveritare për financimin e komunave dhe alokimi i tyre sipas komunave individuale, të aprovuar nga Komisioni i Granteve me datë 22 Prill 2014, duke marrë për bazë aspektet në vijim:

- Parimet e përgjithshme dhe kriteret e përcaktuara në LFPL
- Analizat e standardeve sektoriale të ofruara nga ministritë përgjegjëse
- Përmirësimi i formulës së alokimit për grantet specifike në arsim dhe shëndetësi
- Korniza makro-fiskale si bazë e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve Komunale.

Burimet e Financimit Komunal

Tabela në vijim nr. 1. përmbledhë totalin e burimeve të financimit për komunat për vitet 2015-2017, si vijon:



Tabela 1: Financimi komunal agregat 2015-2017 (mil. Euro)

Përshkrimi	2011 Aktuale	2012 Aktuale	2013 Aktuale	2014 Aktuale	2015 Buxheti	2016 Parashikimi	2017 Parashikimi
1. Grantet qeveritare	295.90	298.83	309.92	319.52	332.07	335.17	338.80
Granti i përgjithshëm	114.20	118.70	128.30	137.57	145.76	145.59	147.94
Granti i përgjithshëm bazë				127.80			
Ndikimi nga regjistrimi i popullsisë 2011, sipas nenit 35 të LFPL				9.77			
Granti specifik për shëndetësi	38.20	39.83	40.43	39.39	42.08	43.92	44.92
Granti specifik për arsim	143.50	140.30	141.19	142.56	144.23	145.66	145.94
Financimi bazë	142.85	139.09	140.32	142.22	143.89	145.32	145.60
Politikat e reja dhe ne vazhdim:	0.65	1.21	0.87	0.34	0.34	0.34	0.34
Qendrat e ekselencës	0.04	0.43	0.87	0.34	0.34	0.34	0.34
Gjuha angleze	0.46	0.78					
Orët e kujdestarisë							
Pedagogët	0.15						
Arsimi joformal							
Kostoja e licencimit							
2. Grantet për kompetencat e	2.85	2.60	2.60	1.85	2.60	2.60	2.60
Kujdesi shëndetësor dytësor	2.85	2.60	2.60	1.85	2.60	2.60	2.60
3. Transferi i Shërbimeve rezidenciale nga MPMS në Skenderaj dhe Graçanicë	-	0.00	0.00	0.24	0.24	0.24	0.24
Shërbimet rezidenciale				0.24	0.24	0.24	0.24
4. Të hyrat vetanake komunale	51.88	60.00	63.00	67.23	74.24	75.63	76.80
5. Financimi kontingjent për decent.	1.50	-	-	-	-	-	-
MAPL (komunat e reja)	1.50						
6. TOTAL FINANCIMI KOMUNAL	352.13	361.43	375.52	388.84	409.16	413.64	418.44
7. Kontigjenca nga Buxheti Qendror për financimin e rritjes së pagave 25%					10		
8. TOTAL FINANCIMI KOMUNAL, përfshirë kontigjencën e pagave	352.13	361.43	375.52	388.84	419.16	413.64	418.44

Tabela 2 më poshtë e zbërthen tabelën 1, për të ofruar burimet e financimit për secilën komunë për vitin 2015.



Tabela 2: Total financimi komunal për vitin 2015

Total Financimi Komunal për vitin 2015								
Nr	Komuna	Granti i përgjithshëm	Granti specifik për Arsimit parauniversitar	Granti specifik për Shëndetësi primare	Shëndetësia sekondare	Financimi i Shërbimeve rezidenciale	Të hyrat vetanake komunale	Total financimi komunal për vitin 2015
1	Deçan	3,197,970	2,335,075	946,169			636,892	7,116,106
2	Dragash	3,394,042	2,302,135	803,791			487,030	6,986,998
3	Ferizaj	8,184,958	10,151,546	2,567,866			4,204,689	25,109,059
4	Fushë Kosovë	2,823,176	2,377,659	823,415			1,822,756	7,847,006
5	Gjakovë	7,487,928	7,004,055	2,235,588			3,026,311	19,753,880
6	Gjilan	6,854,173	8,434,193	2,132,078			3,859,953	21,280,398
7	Glogoc	4,458,511	4,776,086	1,383,848			1,200,874	11,819,319
8	Hani i Elezit	865,478	657,149	222,315			256,258	2,001,199
9	Istog	3,369,804	3,046,842	928,910			1,014,149	8,359,705
10	Junik	624,322	390,710	143,844			91,567	1,250,443
11	Kaçanik	2,647,217	2,543,525	789,889			695,757	6,676,387
12	Kamenicë	3,073,614	2,552,349	853,158			986,433	7,465,553
13	Klinë	3,127,917	3,235,182	910,161			857,767	8,131,028
14	Leposaviq	2,170,664	756,462	325,635			42,888	3,295,649
15	Lipjan	4,563,123	4,788,278	1,361,955			1,342,336	12,055,693
16	Malishevë	4,207,847	5,734,881	1,291,215			755,908	11,989,850
17	Mamusha	818,191	359,283	130,202			64,869	1,372,544
18	Mitrovicë	5,523,924	5,942,343	1,700,144			2,117,292	15,283,703
19	Novo Bërdë	897,591	673,459	159,094			204,672	1,934,815
20	Obiliq	1,797,298	1,786,246	509,483			811,716	4,904,743
21	Pejë	7,698,527	7,244,248	2,280,367			3,394,551	20,617,693
22	Podujevë	6,869,251	7,296,487	2,092,382			1,597,592	17,855,711
23	Prishtinë	14,699,843	15,042,433	4,702,522			27,162,609	61,607,406
24	Prizren	14,356,806	12,962,591	4,203,276			8,275,080	39,797,754
25	Rahovec	4,332,840	4,413,520	1,328,926			1,099,014	11,174,300
26	Shtërpcë	946,649	924,102	164,295	522,371		336,282	2,893,700
27	Shtime	2,193,109	2,438,510	646,021			445,503	5,723,143
28	Skenderaj	4,000,159	4,977,597	1,202,436		133,000	748,155	11,061,347
29	Suharekë	4,629,414	5,104,092	1,412,007			2,117,200	13,262,714
30	Viti	3,653,448	3,898,703	1,110,914			1,008,847	9,671,911
31	Vushtrri	5,343,079	5,596,231	1,651,936			1,675,327	14,266,573
32	Zubin Potok	1,206,609	379,176	156,422			42,888	1,785,096
33	Zveçan	1,118,441	323,938	176,873			42,888	1,662,140
34	Gracanica	1,614,815	1,385,453	252,389	1,090,771	110,000	1,501,093	5,954,520
35	Klllokot	384,206	235,022	60,432			86,849	766,508
36	Mitrovica e Veriut	1,606,553	1,450,219	291,424	989,935		90,066	4,428,196
37	Partesh	369,860	318,281	42,250			46,384	776,775
38	Ranillug	648,646	392,269	91,404			92,768	1,225,086
TOTAL		145,760,000	144,230,328	42,085,037	2,603,077	243,000	74,243,213	409,164,654
Kontigjenca nga Buxheti Qendror për rritjen e pagave 25% për Nivelin Komunal								10,000,000
Total Financimi Komunal								419,164,654



KOMUNAT- Struktura agregate e shpenzimeve për vitin 2015

Komuna	Paga dhe mëditje (fondi 10 dhe 21)	Shpezimet operative nga fondi 10 dhe 21 (mallrat, komunalitet, subvencionet)	Shpezimet Kapitale (fondi 10 dhe 21)	Total
TOTAL	241,314,535	57,850,119	120,000,000	419,164,654

Koment: Rezervat e pashpërndara në shumë prej 3,991,027 euro në kuadër të shpenzimeve operative do të ndahen në procesin buxhetor për të mbuluar financimin e pagave apo shpenzime tjera operative varësisht si do të zhvillohet procesi buxhetor.

Shtojcat 1 deri 6 të kësaj Qarkore ofrojnë detaje rreth ndërtimit dhe strukturës së këtyre burimeve të ndryshme të financimit për Komuna:

- Shtojca 1: Granti i Përgjithshëm
- Shtojca 2: Granti Specifik i Arsimit parauniversitar
- Shtojca 3: Granti Specifik i Shëndetësisë primare
- Shtojca 4: Financimi për Shëndetësinë sekondare
- Shtojca 5: Transferi i Shërbimeve rezidenciale
- Shtojca 6: Të Hyrat Vetanake Komunale

Secila nga këto shtojca 1 deri 5 paraqesin nivelin e granteve qeveritare për vitin 2015, si dhe vlerësimet e nivelit të financimit të granteve për 2016 dhe 2017, ndërsa shtojca 6 paraqet projeksionet e të hyrave vetanake nga komunat për vitin 2015 dhe vlerësimet për vitin 2016-2017. Këto vlerësime të financimit të ardhshëm janë esenciale për përgatitjen e KAB komunale dhe “vlerësimet e hershme”, të diskutuara më poshtë në këtë qarkore.

Kalendari buxhetor dhe hapat e veprimt

Kalendari kohor i buxhetit komunal ofron një përmbledhje të hapave dhe veprimeve që kërkohen gjatë procesit buxhetor komunal 2015-2017, përfshirë afatet kryesore kohore. Version më i detajuar i këtij procesi (fazat e zhvillimit të procesit buxhetor komunal) është i paraqitur në **Shtojcën 7** të kësaj qarkoreje.

Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale (KAB Komunale), përfshirë vlerësimet e hershme dhe projektet shumëvjeçare si dhe financimet nga donatorët

Rekomandohet që komunat të shfrytëzojnë përvojën nga vitet e kaluara dhe ta ndërtojnë procesin e tyre buxhetor në Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunale (KAB Komunale), në harmoni me strategjinë zhvillimore komunale dhe në koordinim me financimet nga donatorët. KAB komunale duhet të përfshijë për tre vitet e ardhshme fiskale, elementet në vijim:

- (a) Parashikimet dhe supozimet ekonomike dhe buxhetore;
- (b) Strategjinë zhvillimore komunale dhe planet integruese të tyre;
- (c) Totalët e vlerësuar të të hyrave nga të gjitha burimet e financimit nga grantet qeveritare, të hyrat vetanake komunale përfshirë participimin e qytetarëve, dhe



- bashkëfinancimet nga ministritë e linjës në përputhje me parashikimet e veta ekonomike dhe buxhetore të përfshira në KAB Komunal;
- (d) Caqet totale për shpenzime në programe dhe nën-programe buxhetore sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve për çdo vit buxhetor që do të kontribuojnë në plotësimin e qëllimeve të cekura në strategjitë zhvillimore komunale dhe planet integruese komunale;
 - (e) Vlerësimi i projekteve ekzistuese nga drejtoritë komunale duke i krahasuar me arritjen e prioritetëve dhe cakteve të caktuara nga strategjia zhvillimore komunale dhe planet integruese komunale;
 - (f) Vlerësimet e mbështetjes së pritur të donatorëve dhe agjencive qeveritare ndërkombëtare, përfshirë bashkëfinancimin e IPA-s.

Gjatë hartimit të KAB Komunal, autoritetet komunale në bashkëpunim me komunitetet dhe palët kryesore me interes duhet të konsultohen, përfshirë organizimin e diskutimeve publike për diskutimin e prioritetëve dhe strategjive komunale.

Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF) duhet të organizoj gjithashtu takime publike për të diskutuar prioritetet dhe strategjitë para aprovimit të këtij dokumenti. KAB Komunal e aprovuar, duhet të publikohet për qasje publike, me një kopje të dorëzuar në MF-Departamentin e Buxhetit Komunal jo më vonë se me 30 Qershor 2014.

Nga komunat kërkohet që të hartojnë KAB Komunal 2015-2017 dhe përgatitjen e buxhetit në bazë trevjeçare, atëherë të keni në konsideratë se shtojcat 1-6 të pasqyruara në këtë qarkore ofrojnë detaje rreth shumës së secilit burim të financimit/grant qevritar për secilën komunë për vitin 2015 dhe vlerësimet për vitin 2016-2017 si dhe shtojcat 7-8 ofrojnë informata shtesë për zhvillimin e procesit buxhetor për vitin 2015-2017.

Vlerësimet e hershme janë elementet kryesore në përgatitjen e projeksioneve indikative buxhetore për 2015 dhe do të shërbejnë si projeksione për 2016 dhe 2017. Vlerësimet e hershme janë në veçanti të rëndësishme për shqyrtimin adekuat të shpenzimeve operative dhe kapitale. Duhet ti kushtohet vëmendje kursimeve buxhetore të cilat do të mund të identifikohen duke analizuar aktivitetet e përfunduara në vitet e kaluara dhe të cilat nuk do të përsëriten gjatë vitit vijues.

Komunat duhet të shqyrtojnë obligimet e tyre ligjore ekzistuese dhe politikat prioritare komunale në përgatitjen e vlerësimeve të hershme, në vijim:

- Projektet përcjellëse në vazhdim për periudhën 2015-2017,
- Zotimet e Qeverisë për Programin - Instrumenti i Para-Anëtarësimit (IPA),
- Plani i Veprimtimit të Partneritetit Evropian (PVPE),
- Komunat duhet të kujdesen që nëse hyjnë në obligime për bashkëfinancim vetëm deri në nivelin që lejon korniza e tyre buxhetore, rregullës fiskale dhe kuadrit ligjor,
- Legjislacioni i ri ose ndryshimi/plotësimi i atij ekzistues.



Buxhetimi i programeve i bazuar në performancë

Buxhetimi i programeve i bazuar në performancë do të fokusohet rreth objektivave, strategjive, rezultateve dhe rezultateve të pritura gjatë procesit buxhetor.

Buxhetimi i bazuar në performancë nënkupton:

- Identifikimi i objektivave dhe vendosja e caqeve të matshme për drejtoritë duke u bazuar në prioritetet e strategjisë zhvillimore komunale dhe planeve integruese
- Buxhetimi i aktiviteteve të secilës drejtori do të mundësoj arritjen e rezultateve të pritura. Rrjedhimisht ky model i buxhetimit do të mundësoj monitorimin dhe vlerësimin e performancës së drejtorive komunale.

Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinator (BPGj) - Të punohet drejt implementimit të Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjinator sipas praktikave ndërkombëtare duke bërë të dukshme efektet e shpenzimeve publike në barazinë e grave dhe burrave, djemve dhe vajzave në mënyrë që të kontribuohet në efektivitetin dhe transparencën e menaxhimit të financave publike. Bazuar në punën e pilot projektit në Komunën e Kamenicës, ne synojmë të zgjerojmë këtë punë edhe në komunat tjera në Republikën e Kosovës në vitet në vijim. Prandaj, ju inkurajojmë që të filloni të reflektoni lidhur me ndjeshmërinë gjinore të buxheteve të komunave tuaja.

Komunat janë të obliguara të plotësojnë formularin që ka të bëjë me misionin dhe performancën buxhetore të secilit program buxhetor apo sektorë (**Shtojca 8**).

Dorëzimi i Buxheteve Komunale në MF

Komunat në fund të procesit buxhetor janë të obliguara të aprovojnë tabelat e buxhetit të cekura më poshtë me dokumentacionin mbështetës për 2015-2017, dhe të dorëzojnë në Departamentin e Buxhetit Komunal në MF, **jo më vonë se 30 shtator 2014**, si në vijim:

1. Shkresa përcjellëse bazuar në aprovimin e buxhetit nga Kuvendi Komunal (të nënshkruar nga Kryetari i Komunës).
2. Vendimi i Kuvendit Komunal mbi miratimin e buxhetit komunal për vitin 2015 dhe projektet shumëvjeçare për vitin 2016-2017.
3. Tabelat e buxhetit komunal (BDMS dhe PIP):
 - Tabela 4.1 – plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve totale të komunës për vitin 2015 (kopje e shtypur prej BDMS, dhe të nënshkruara).
 - Tabela 4.2 – financimi vjetor i projekteve kapitale komunale për vitin 2015 dhe projekteve kapitale shumëvjeçare për vitin 2016-2017 (shtypur nga sistemi PIP, dhe të nënshkruara).
 - Tabela 4.3 – plani afatmesëm i të hyrave totale të buxhetit komunal (të shtypur nga BDMS, dhe të nënshkruara).



Autonomia financiare në nivel të shkollës

Komunat do ta implementojnë buxhetin e deleguar në shkolla ashtu si kërkohet me Ligjin për Arsimin parauniversitar, si dhe alokimi i shumës së buxhetit në secilën shkollë në një komunë duhet të përcaktohet përmes një formule financiare komunë-shkollë që i plotëson kriteret dhe standardet e përcaktuara nga MASHT-MF. Komunat e përfshira në decentralizimin e buxhetit në nivel të shkollës duhet të përgatisin buxhetet e tyre për ekzekutim për të gjitha shkollat në bashkëpunim me MASHT-MF-MAP.

Programi i investimeve publike (PIP)

Planifikimi i buxhetit për investime kapitale bëhet përmes sistemit elektronik të PIP-it. Procedurat mundësojnë arsyetimin e buxhetit kapital, identifikimin se si projekti e mbështetë implementimin e prioriteteve të komunës, menaxhimit të projekteve, planifikimin e kostos kapitale të projektit dhe vlerësimin e buxhetit periodik.

Projektet duhet të formulohen në baza shumëvjeçare për të siguruar se kostot e plota të vënies së projektit në operim janë përfshirë në një propozim të vetëm PIP. Pasi që një projekt i vazhdueshëm (2014) të caktohet të vazhdojë në 2015 (dhe/ ose më tej), ju duhet të azhurnoni draft propozimin që ishte buxhetuar për 2014 (çfarëdo ndryshimi në plane, buxhet etj) **për projekt të vazhdueshëm nuk duhet të bëhet propozim i ri.**

Propozimet për projekte që janë caktuar të fillojnë në 2014 dhe 2015, duhet gjithashtu të formulohen duke përdorur sistemin PIP për të siguruar vlerësimet e hershme për buxhetin kapital.

Vetëm projektet kapitale të aprovuara nga Kuvendi Komunal duhet të dorëzohen në departamentin e buxhetit komunal në Ministrinë e Financave. **Prioritet për financim duhet t'i jepet projekteve të buxhetuara të vazhdueshme që janë nisur në vitet e mëparshme dhe atyre që janë në harmoni me prioritetet e komunës.** Manuali dhe udhëzimet për PIP mund të shkarkohen prej www.pip-ks.org.

Sistemi i menaxhimit të të dhënave të buxhetit (BDMS)

Sistemi për zhvillim të buxhetit dhe menaxhim (BDMS) është sistem financiar që mundëson zhvillimin e buxhetit për të gjitha kategoritë ekonomike operationale (sikurse numri i stafit, pagat dhe mëditjet, mallrat dhe shërbimet, shpenzimet komunale, subvencionet dhe transferet).

Manuali i përdoruesve të BDMS-së mund të shkarkohet prej ueb faqes : www.bdms-ks.org.

Sistemet elektronike BDMS dhe PIP nuk do të lejojnë në asnjë rast tejkalim të kufijve të lëshuar me qarkoren buxhetore për vitin 2015. Pasi të futen të dhënat buxhetore të aprovuara në BDMS dhe PIP, sistemet janë të gatshme të gjenerojnë raportet: raportet përmbledhëse, raportet e detajuara si dhe Tabelat 4.1, 4.2 dhe 4.3, të bazuar në tabelat e ligjit vjetor të buxhetit.

Nëse keni ndonjë pyetje rreth udhëzimeve në këtë qarkore, komunat mund të konsultohen me analistët e departamentit të buxhetit komunal në Ministrinë e Financave.



Shpërndarja e Qarkores Buxhetore në nivelet komunale


Autoritetet komunale janë të obliguara ta shpërndajnë këtë Qarkore Buxhetore tek të gjithë zyrtarët komunal të angazhuar në procesin e hartimit të buxhetit.

Të gjitha autoritetet komunale janë përgjegjëse për organizimin kohor të angazhimeve dhe aktiviteteve të tyre në përputhje me orarin e hartimit të buxhetit, në mënyrë që ta mbështesin plotësisht përgatitjen e buxhetit, respektimin e udhëzimeve buxhetore, përfundimin dhe aprovimin si dhe dorëzimin me kohë të buxheteve komunale në MF.

Forumet me autoritetet komunale - Trajnimet dhe informatat shtesë

Departamenti i Buxhetit Komunal në MF do të organizojë forume me autoritetet komunale dhe ofrojë trajnime dhe informatat shtesë lidhur me zhvillimin e procesit buxhetor komunal për vitin 2015-2017, duke përfshirë edhe përfaqësuesit e ministrive të linjës MASHT, MSH, MPMS, MAPL, MAP, MIE etj, si dhe ZAP, Zyra e KE, OSBE, USAID, FMN, BB, GIZ etj. Trajnimet do të ofrojnë një pasqyrë të përgjithshme të proceseve dhe reformave për zyrtarët e buxhetit. Trajnimi shtesë do të përfshijë module më specifike trajnuese për secilën nga fazat kyçe të buxhetit. Orari dhe agenda për trajnimet përkatëse do ti ofrohet komunave .

Me respekt,



Besim Beqaj
Ministër i Financave



Shtojca 1. Granti i Përgjithshëm

Komunat do të pranojnë Grantin e përgjithshëm, i përcaktuar si grant me sistem të mbyllur dhe do ta shfrytëzojnë për ushtrimin e kompetencave të caktuara komunale në përputhje me kuadrin ligjor.

Granti i Përgjithshëm mundëson një shkallë të arsyeshme të qëndrueshmërisë në të hyrat komunale, gjithashtu është mjet adekuat për vendosjen e barazive ndërmjet komunave, dhe mundëson alokimin adekuat të burimeve për komunitet pakicë në komunat përkatëse.

Bazuar në LFPL, shuma e Grantit të përgjithshëm është e përcaktuar me dhjetë përqind (10%) e të hyrave totale të buxhetuara të Qeverisë qendrore, duke përjashtuar të hyrat nga shitja e aseteve, të hyrat tjera të jashtëzakonshme, të hyrat e dedikuara vetanake dhe të hyrat nga huamarrja.

Me qëllim të nivelizimit të kapacitetit të ulët të të hyrave vetanake të komunave më të vogla, secila komunë do të pranojë për çdo vit një shumë të përgjithshme fikse (paushalle) prej 140,000 € minus 1 € për kokë banori, ose 0 € për komunat me popullsi të barabartë ose më të madhe se 140,000 banorë. Kriteret bazë të formulës për alokimin e grantit të përgjithshëm në komuna janë:

Numri i popullsisë llogaritet me tetëdhjetë e nëntë përqind (89%); përmasat gjeografike të komunës me gjashtë përqind (6%); numri i popullsisë pakicë në komunë (3%); komunat ku shumica e popullsisë së të cilave përbëhet nga pakicat kombëtare me dy përqind (2%).

Granti i përgjithshëm në shumë prej 145,760,000 euro për vitin 2015 është aprovuar nga Komisioni i Granteve me datë 22 prill 2014, sipas primeve, kriterëve dhe formulës bazë të përcaktuar në LFPL.

Financimi i shërbimeve sociale si kompetencë e transferuar nga MPMS në komuna përmes memorandumeve të mirëkuptimit, është përfshirë në kuadër të grantit të përgjithshëm të komunës. Gjatë përgatitjes së buxheteve komunale për 2015-2017 nga komunat kërkohet që të shqyrtojnë me kujdes sektorin e shërbimeve sociale dhe të ri-planifikojnë shërbimet sociale bazuar në një analizë lokale të sektorit dhe jo në bazë të planifikimeve të viteve të mëparshme. Komunat duhet të marrin në konsideratë një rritje progresive në shpenzimet e shërbimeve sociale për të përfshirë shërbimet sociale që nuk ofrohen aktualisht, duke përfshirë projekte për përmirësimin e shërbimit, duke përfshirë blerjen e pajisjeve dhe rregullimin e hapësirave të përshtatshme, dhe për t'u përgatitur për projekte të përbashkëta për ofrimin e shërbimeve sociale që do të zbatohen me ndihmën e OJQ-ve dhe ndërmarrjeve sociale të licencuara. BE-ja, përmes IPA 2014 është duke e përgatitur një investim për mbështetjen e aktiviteteve të MPMS-së dhe të komunave në përmirësimin e ofrimit të shërbimeve sociale nëpërmjet fondeve të granteve të skemave komunale për shërbime sociale për të përfshirë OJQ-të e licencuara dhe ndërmarrjet sociale. Megjithatë, kjo është e kushtëzuar në efektet që ofrojnë komunat që ata kanë të rritur buxhetin e tyre për këto shërbime sociale.

Të punësuarit në administratën e Drejtorive Komunale për Arsim parauniversitar, në pajtim me parimet dhe kriteret e përcaktuara në LFPL, duhet të financohen nga Granti i Përgjithshëm në komuna.



Të punësuarit në administratën e Drejtorive Komunale për Shëndetësi primare dhe Shëndetësi sekondare (Graçanicë, Shtërpçë dhe Mitrovicë veriore), në pajtim me parimet dhe kriteret e përcaktuara në LFPL, duhet të financohen nga Granti i Përgjithshëm në komuna.

Për zbatimin e nenit 35 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049, bazuar në regjistrimin e popullsisë të vitit 2011 dhe të publikuara zyrtarisht nga ASK në muajin dhjetor 2012, përfshirë vlerësimet e Agjencionit Statistikor të Kosovës (ASK) për katër komunat minoritare të cilat nuk kanë marrë pjesë në procesin e regjistrimit të popullsisë, si: Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë veriore. Qeveria e Republikës së Kosovës me Vendim Nr.09/121 të datës 27.03.2013 ka aprovuar ndryshimin e Shtojcës 1 të LFPL për numrin e ri të popullsisë. Ndërsa, me Vendimin e Qeverisë Nr. 07/170 datë 14.02.2014 është aprovuar plotësim/ndryshimi i Shtojcës I të LFPL për numrin e popullsisë për katër komunat veriore Leposaviq, Zveçan, Zubin Potok dhe Mitrovicë veriore, dhe sipas pikës 1 të këtij vendimi do të vlejë vetëm për vitin 2014, ndërsa nuk do të ketë efekte për vitet pasuese, dhe marrja e vendimit nga Komisioni i Granteve është bazuar në statistikat e Shtojcës I të aprovuar në Qeveri me Vendim Nr.09/121 të datës 27.03.2013.

Struktura e Grantit të Përgjithshëm për periudhën 2011-2017 (mil. Euro)

Kriteret	Faktorët	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017
		Buxheti	Buxheti	Buxheti	Aktual	Buxheti	Vlerësimi	Vlerësimi
Shuma agregate	Të hyrat buxhetore (mil euro)	1,056.0	1,187.0	1,283.0	1,278.0	1,457.6	1,455.9	1,479.4
	10% e të hyrave buxhetore (mil euro)	105.5	118.7	128.30	127.80	145.76	145.59	147.94
Kosto shtesë nga Niveli Qendror	Ndikimi nga regjistrimi i popullsisë 2011, sipas nenit 35 të LFPL				9.77			
Elementet	Shuma Fikëse	3.40	3.40	3.40	3.63	3.63	3.63	3.63
	Popullsia	2,236,963	2,236,963	2,236,963	1,780,021	1,780,021	1,780,021	1,780,021
	Parametri: 89% e shumës agregate	90.91	102.6	111.2	110.5	118.06	121.4	122.5
	Zona komunale (km2)	10,901	10,901	10,901	10,901	10,901	10,901	10,901
	Parametri: 6% e shumës agregate	6.13	6.9	7.5	7.45	7.9	8.2	8.3
	Komunitetet pakicë në komunë	116,599	116,599	116,599	107,926	107,926	107,926	107,926
	Parametri: 3% e shumës agregate	3.06	3.5	3.7	3.7	3.9	4.3	4.1
	Popullsia e komunave pakicë	130,255	130,255	130,255	62,031	62,031	62,031	62,031
	Parametri: 2% e shumës agregate	2.04	2.3	2.5	2.4	2.6	2.7	2.7
Total granti i përgjithshëm		105.5	118.7	128.3	137.57	145.76	145.59	147.94



Formulat e ndarjës së Grantit të Përgjithshëm

Kritere	Viti 2015			Viti 2016			Viti 2017		
	1.457,6	1.457,6	1.479,4	1.571,8	1.572,5	1.592,2	1.671,8	1.672,5	1.703,2
Të hyrat e Buxhetit në Buxhetin e Kosovës (në)	145.760,000	145.760,000	147.940,000	157,182	157,250	159,282	167,182	167,250	170,322
Granti i Përgjithshëm (10%)	14,576	14,576	14,794	157,182	157,250	159,282	167,182	167,250	170,322
Shuma Fikse	140,000	140,000	140,000	140,000	140,000	140,000	140,000	140,000	140,000
Popullsia	140,000	140,000	140,000	140,000	140,000	140,000	140,000	140,000	140,000
Madësia gjeografike	140,000	140,000	140,000	140,000	140,000	140,000	140,000	140,000	140,000
Popullsia Prace	140,000	140,000	140,000	140,000	140,000	140,000	140,000	140,000	140,000
Komunitet me Popullsi Prace	140,000	140,000	140,000	140,000	140,000	140,000	140,000	140,000	140,000
Granti i Përgjithshëm	140,000	140,000	140,000	140,000	140,000	140,000	140,000	140,000	140,000

Komuna	Viti 2015			Viti 2016			Viti 2017		
	1.457,6	1.457,6	1.479,4	1.571,8	1.572,5	1.592,2	1.671,8	1.672,5	1.703,2
1. Dugan	40,019	297	2,73%	50,1	0,51%	99,981	2,845,783	292,437	21,768
2. Dragash	83,987	430	3,96%	13,559	12,58%	106,003	2,415,855	335,526	535,539
3. Ferizaj	108,610	345	3,17%	4,193	3,89%	31,390	7,717,917	270,003	166,548
4. Fushë Kosovë	34,827	83	0,78%	4,511	4,18%	106,173	2,474,836	64,957	178,211
5. Gjakovë	94,556	167	5,39%	6,679	6,19%	46,444	6,719,228	459,396	283,959
6. Glljan	90,178	382	3,80%	2,284	2,10%	49,822	6,406,124	305,786	89,441
7. Glogoc	58,531	276	2,53%	45	0,04%	4,199,262	216,002	1,728	-
8. Hajll Ellezit	9,403	83	0,76%	44	0,04%	130,597	668,185	64,957	1,728
9. Istog	39,289	454	4,71%	3,085	2,86%	2,791,909	355,308	121,875	-
10. Junik	6,034	74	0,68%	4	0,00%	100,711	432,334	57,914	198
11. Kacanik	33,409	211	1,94%	36	0,03%	106,591	2,374,071	165,132	1,422
12. Kamenice	36,085	424	3,89%	1,854	1,73%	103,915	2,561,230	331,830	73,639
13. Klinë	38,496	309	2,84%	1,241	1,16%	101,504	2,785,558	241,829	49,027
